



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA E TIRANËS  
QENDRA EKONOMIKE E ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

Nr. \_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM  
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

**Data 19.03.2019**

**Për:** Delta Doni Sh.p.k, me adresë kryesore Gorre, Kolonjë, Fier

\* \* \*

Procedura e prokurimit: **Procedurë e Hapur**

Numri i Referencës për Procedurën: **Loti II “Blerje bulmet, qumësht, djathë, gjizë”:** REF-  
**92734-11-05-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje Ushqime” për QEZHEF – Marreveshje Kuadër - me disa operatorë ekonomik ku të gjitha kushtet janë të percaktuara – Me një Operator Ekonomik fitues për çdo Lot - Me afat të Marrëveshjes Kuadër 12 muaj, ndarë në lote: Loti II – “Blerje bulmet, qumësht, djathë, gjizë” - me fond limit 59 495 617 (pesëdhjetë e nëntë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa T.V.SH.**

<b>Loti II: "Blerje bulmet , qumësht, djathë, gjizë"</b>			
Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia e pritshme
1	Qumesht tetrapak	Litra	303 000
2	Kos	Kg	160 500
3	Djath i bardhe	Kg	5 200
4	Djath kaçkavall	Kg	600
5	Gjize pa kripe	Kg	19 300

**Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin do të jetë nga data e nënshkrimit të kontratës me përfundim të periudhës 12 mujore të Marrveshjes Kuader.**

Publikime të mëparshme: **Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 45, Datë 12 Nëntor 2018**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme X çmimi më i ulët

**Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:**

1. Nelsa Sh.p.k

J71601012S

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera 1 280 (një mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekë pa T.V.SH.

2. A G S Sh.p.k

K62121038G

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera 1 458.35 (një mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e pesë) lekë pa T.V.SH.

3. DELTA DONI Sh.p.k

K14117401B

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera 1 327.5 (një mijë e treqind e njëzet e shtatë pikë pesë) lekë pa T.V.SH.

### **Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:**

1. Nelsa Sh.p.k

J71601012S

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

### **Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

1.1 Kriteret e veçanta pika 2.3.8, operatori ekonomik nuk ka dorëzuar mostrat sipas specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor për artikujt e kërkuar:

#### **1.1.1 Artikulli “Qumësht Tetrapak”**

Plotëson pjesërisht kriteret për markerimin dhe etiketimin.

Në mostrën e paraqitur nuk është përshkruar përqindja e yndyrës.

Në raport Analizën e paraqitur, nuk është përshkruar emërtimi i plotë i produktit, por është përcaktuar: Qumësht UHT. Në Raport Analizën e paraqitur nuk janë analizuar të gjithë treguesit e kërkuar në specifikimet teknike për këtë produkt. Nuk janë analizuar treguesit:

Dendësia në 20 gradë celcius jo më pak se 1.028 – 1.029 gr/litër. Pika e ngrirjes jo më e lartë se

-0,520 gradë C. Përmbajtja e lëndës së thatë, pa yndyrë, jo më pak se 8.5 %. Prova e pasterizimit (e fosfatazes dhe peroksidezes) duhet negative. Në raport analizën e paraqitur, data e skadencës së artikullit të analizuar është 08.12.2018, ndërsa mostra e paraqitur e ka datën e skadencës 28.02.2019. Kjo do të thotë që mostra e paraqitur nuk përputhet me Raport Analizën e paraqitur. Për këtë artikull, OE nuk ka paraqitur Raport Analizë Mikrobiologjike sikurse kërkohet në dokumentat e tenderit. Mbi ambalazhin e mostrës së paraqitur, nga ana e OE, është vendosur vetëm vula me emrin e OE, dhe jo informacioni i kërkuar në dokumentat e tenderit me të dhënat: Moster “emri i artikullit”, Data e zhvillimit të tenderit, emri i ofertuesit, nënshkrimi dhe vula e operatorit ekonomik.

### **1.1.2 Artikulli “Kos”**

Plotëson pjesërisht kriteret për markerimin dhe etiketimin. Në mostrën e paraqitur mungon data e prodhimit në ambalazh. Ka paraqitur në origjinal Analizën Fiziko-Kimike me Raport Prove nr. C/7727/2018, datë 22.11.2018, të kryera nga ISUV, ku plotësohen të gjithë treguesit e kërkuar në dokumentat e tenderit, por data e skadencës së produktit të analizuar, e shkruar në Raport Analizë është 08.12.2018, ndërkohë që mostra e paraqitur e ka datën e skadencës 25.12.2018. Kjo mos përputhje tregon se mostra e paraqitur nuk përputhet me Raport Analizën e paraqitur. Për këtë artikull OE nuk ka paraqitur Raport Analizë Mikrobiologjike sikurse kërkohet në dokumentat e tenderit. Mbi ambalazhin e mostrës së paraqitur nga ana e OE, është vendosur vetëm vula me emrin e OE, dhe jo informacionin e kërkuar në dokumentat e tenderit me të dhënat: Moster “emri i artikullit”, Data e zhvillimit të tenderit, emri i ofertuesit, nënshkrimi dhe vula e operatorit ekonomik.

### **1.1.3 Artikulli “Djath i bardhë”**

Plotëson pjesërisht kriteret për markerimin dhe etiketimin. Në mostrën e paraqitur mungon data e prodhimit në ambalazh. Në raport Analizën e paraqitur, nuk është përshkruar emërtimi i plotë i produktit, por është përcaktuar emërtimi “Djath i bardhë”. Në Raport Analizën e paraqitur nuk janë analizuar të gjithë treguesit e kërkuar në specifikimet teknike për këtë produkt, si dhe në këtë Raport Analizë nuk është përcaktuar data e skadencës së produktit të analizuar. Nuk është analizuar treguesi: Lendet e thata në %. Për këtë artikull, OE nuk ka paraqitur Raport Analizë Mikrobiologjike sikurse kërkohet në dokumentat e tenderit. Mbi ambalazhin e mostrës së paraqitur, nga ana e OE, është vendosur vetëm vula me emrin e OE dhe jo informacioni i kërkuar në dokumentat e tenderit me të dhënat: Moster “emri i artikullit”, Data e zhvillimit të tenderit, emri i ofertuesit, nënshkrimi dhe vula e operatorit ekonomik.

### **1.1.4 Artikulli “Djath Kaçkavall”**

Në Raport Analizën e paraqitur nuk janë analizuar të gjithë treguesit e kërkuar në specifikimet teknike për këtë produkt, si dhe nuk është përcaktuar data e skadencës së produktit të analizuar. Nuk janë analizuar treguesit: Përmbajtja e lëndëve të thata në % jo më pak se 57-60%. Yndyrnat në lëndët e thata jo më pak se 30-50%. Për këtë artikull, OE nuk ka paraqitur Raport Analizë Mikrobiologjike sikurse kërkohet në dokumentat e tenderit. Mbi ambalazhin e mostrës së paraqitur nga ana e OE, është vendosur vetëm vula me emrin e OE, dhe jo informacioni i

kërkuar në dokumentat e tenderit me të dhënat: Moster “emri i artikullit”, data e zhvillimit të tenderit, emri i ofertuesit, nënshkrimi dhe vula e operatorit ekonomik.

### 1.1.5 Artikulli “Gjizë pa kripë”

Mostra e paraqitur nga OE është gjizë me masë 0.5 kg, e cila është pakeluar në vasketë plastike të valëzuar por pa asnjë etiketim apo markerim sikurse kërkohet në specifikimet teknike për këtë produkt. Në Raport Analizën e paraqitur nuk janë analizuar të gjithë treguesit e kërkuar në specifikimet teknike për këtë produkt, si dhe në këtë Raport Analizë nuk është përcaktuar data e skadencës së produktit të analizuar. Nuk është analizuar treguesi: Yndyrë ne e %, jo me pak se 3. Për arsye se mostra e paraqitur nuk është e etiketuar, nuk gjendet asnjë e dhënë që mostra e paraqitur të ketë lidhje me Raport Analizën e paraqitur. Mbi ambalazhin e mostrës së paraqitur, nga ana e OE, është vendosur vetëm vula me emrin e OE, dhe jo informacioni i kërkuar në dokumentat e tenderit me të dhënat: Moster “emri i artikullit”, data e zhvillimit të tenderit, emri i ofertuesit, nënshkrimi dhe vula e operatorit ekonomik.

### Janë kualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. DELTA DONI Sh.p.k

K14117401B

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera 1 327.5 (një mijë e treqind e njëzet e shtatë pikë pesë) lekë pa T.V.SH / Pikët totale të marra \_\_\_\_ (me numra dhe fjalë)

2. A G S Sh.p.k

K62121038G

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera 1 458.35 (një mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e pesë) lekë pa T.V.SH / Pikët totale të marra \_\_\_\_ (me numra dhe fjalë)

\* \* \*

### Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se është identifikuar si operator ekonomik i suksesshëm:

DELTA DONI Sh.p.k

K14117401B

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera 1 327.5 (një mijë e treqind e njëzet e shtatë pikë pesë) lekë pa T.V.SH / Pikët totale të marra \_\_\_\_ (me numra dhe fjalë)

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë **Autoritetit Kontraktor, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve**, me adresë Rr. “Barrikadave”, Çerdhja Nr. 1, Tiranë, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft

marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 18.12.2018

Njoftimi i Ri- Klasifikimit është bërë në datë 06.03.2019

Ankesa: Ka patur ankesë nga ana e Operatorit Ekonomik “**DELTA DONI**” Sh.p.k dhe ka marrë përgjigje në datë 26.12.2018 nga ana e AK QEZHEF.

Operatorit Ekonomik “**DELTA DONI**” Sh.p.k në vijim ka depozituar ankesë pranë KPP-së.

Referuar vendimit të KPP-së Nr. 123/2019 datë 06.03.2019 është bërë rivlerësimi i ofertave.

**Titullari i autoritetit kontraktor**

**Zhaneta Beqiri**